



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E LEGJISLACIONIT
DREJTORIA E PROKURIMIT PUBLIK

Nr. _____ Prot.

Fier, më 14.09.2022

Lënda: Dërgohet Njoftimi i Kontratës në formë elektronike për tenderin “Blerje pajisje sportive për zhvillimin e ndeshjeve sportive në Pallatin e Sportit të lojrave me dorë”, me burim financimi nga Buxheti i Bashkisë Fier

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK
TIRANË
(për botim)

BASHKIA FIER

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor

Emri Bashkia Fier
Adresa Lagja “Kastriot”, Rruga “Ramiz Aranitasi”, Nr.15
Tel/Faks +355 34 410 650
E-mail prokurimetfier@gmail.com
Ueb-faqe www.app.gov.al

2. Lloji i procedurës së prokurimit: E hapur e thjeshtuar me mjete elektronike.

3. Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF-41657-09-14-2022

4. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Blerje pajisje sportive për zhvillimin e ndeshjeve sportive në Pallatin e Sportit të lojrave me dorë”

5. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Tabela elektronike për shënimin e pikëve - 31711200-5 ; Stola - 39113500-2; Sisteme te plota loje per basketboll -37452210-6

6. Fondi limit: 8 459 827 (tetë milion e katërqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e njëzet e shtatë) lekë pa TVSH

Shënim: Në bazë të shkresës nr.7040 prot. datë 29.08.2022 të Drejtorisë së Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit, për financimin dhe fillimin e procedurave të prokurimit publik me objekt “**Blerje pajisje sportive për zhvillimin e ndeshjeve sportive në Pallatin e Sportit të lojrave me dorë**”, objekti i prokurimit do të kontraktohet dhe zbatohet me vlerë të plotë, por për vitin 2022 do të financohet në vlerën prej **10 000 000 (dhjetë milion) lekë me TVSH**, ndërsa pjesa tjetër e mbetur e kontratës do të financohet në vitin buxhetorë 2023, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

7. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: jo më vonë se 45 (dyzet e pesë) ditë nga nënshkrimi i kontratës.

8. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 26/09/2022 (d/m/v) Ora: 10:00.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
ZYRTARI I AUTORIZUAR**

Zv.Kryetari

Andius OLLDASHI